


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Korrik, 2023

**Tiranë, më 16 Gusht 2023:** Në Korrik 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 38 mld lekë, duke u ulur me -4,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me -0,6 %, në krahasim me Qershor 2023. Importet e mallrave arritën vlerën 71 mld lekë, duke u ulur me -13,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me -6,0 %, në krahasim me Qershor 2023. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 33 mld lekë, duke u ulur me -22,6 %, krahasuar me Korrik 2022 dhe me -11,6 %, në krahasim me Qershor 2023.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë shtatëmuor eksportet e mallrave arritën vlerën 272 mld lekë, duke u ulur me -7,0 %, krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 509 mld lekë, duke u ulur me -3,5 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 237 mld lekë, duke u rritur me 0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Korrik 2023, në uljen e eksporteve prej -4,0 %, kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -8,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,8 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -1,1 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +6,9 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +2,0 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Korrik 2023**




Eksportet, gjatë këtij shtatëmujori janë ulur me -7,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -7,0 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,0 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,9 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +2,1 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,6 pikë përqindje, etj.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të impORTEVE:**

Gjatë muajit Korrik 2023, në uljen e impORTEVE prej -13,6 %, krahasuar me Korrik 2022, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -6,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -3,4 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -2,8 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht ka ndikuar grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,8 pikë përqindje, etj.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të impORTEVE, Korrik 2023**



Si shtatëmujor, importet janë ulur me 3,5 %, krahasuar me shtatëmujorin e parë 2022. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,3 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me -0,6 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,1 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,1 pikë përqindje, etj.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Korrik 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2022 janë: Italia (10,6 %), Austri (78,4 %), SHBA (63,4 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritje më të madhe, janë: Kosova (24,3 %), Greqia (12,2 %), Mbretëria e Bashkuar (1.632,8 %), etj.

Gjatë këtij shtatëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (10,6 %), Gjermania (23,8 %), Kina (32,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Kosova (7,7 %), Greqia (15,6 %), Spanja (57,9 %), etj.

Në muajin Korrik 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (7,4 %), Turqia (16,3 %), Greqia (29,8 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Korrik 2022 janë: Kina (10,1 %), Gjermania (6,5 %), SHBA (28,2 %), etj.

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (18,2 %), Greqia (14,9 %), Italia (4,3 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kina (34,5 %), Zvicra (79,5 %), SHBA (45,6 %), etj.

**Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2023**



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 59,2 %, të gjithë tregtisë. Në Korrik 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,2 %), Kina (7,8 %), Gjermania (6,6 %) dhe Greqia (6,5 %).

Shkëmbimet tregtare, për shtatëmuajorin e parë 2023, me vendet e BE-së zënë 59,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Korrik 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,4 %), Kina (7,6 %), Turqia (6,8 %) dhe Greqia (6,7 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Korrik 2023

Vitet	Muajt	Eksporte	Ndryshimi	Importe	Ndryshimi	Bilanci Tregtar	Mbulimi
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	Janar– Korrik 20	150	-16,7	328	-13,1	-178	45,7
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	Janar – Korrik 21	209	39,2	426	29,8	-217	49,0
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	Janar– Korrik 22	293	40,1	528	23,9	-235	55,4
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	Janar– Korrik 23	272	-7,0	509	-3,5	-237	53,4

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Korrik 2023

	Eksporte				Importe			
	Korrik 2022	Korrik 2023	Janar - Korrik 2022	Janar - Korrik 2023	Korrik 2022	Korrik 2023	Janar - Korrik 2022	Janar - Korrik 2023
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>30.816</b>	<b>27.339</b>	<b>216.316</b>	<b>200.910</b>	<b>44.866</b>	<b>38.273</b>	<b>280.350</b>	<b>263.753</b>
Austri	788	170	2.875	2.357	583	770	3.888	4.407
Gjermani	1.737	1.923	20.235	14.810	4.930	5.251	32.597	35.472
Greqi	2.126	2.386	16.054	18.558	6.593	4.625	39.901	33.955
Itali	18.321	16.374	134.015	119.763	18.837	17.442	122.916	117.592
Spanjë	1.773	2.285	7.473	11.800	1.830	1.218	8.759	7.621
Kroaci	401	273	4.757	3.379	1.246	881	5.268	4.340
Të tjera të BE-së	5.669	3.928	30.907	30.242	10.847	8.086	67.021	60.366
Mbretëri e Bashkuar	149	2.574	1.282	3.426	748	629	4.434	4.850
Kinë	316	607	7.287	4.902	7.097	7.812	40.593	54.596
Kosovë	2.740	3.404	22.085	23.779	1.502	987	9.070	6.398
Maqedonia e Veriut	1.073	1.097	10.060	11.197	981	1.055	8.685	7.833
Rusi	-	-	12	8	639	243	6.325	2.825
SHBA	720	264	6.016	2.499	1.142	1.465	7.104	10.345
Turqi	253	233	3.696	2.454	7.124	5.964	62.168	50.878
Ukrainë	85	26	358	1.020	302	468	2.344	2.450
Zvicër	75	526	2.341	3.540	782	515	4.546	8.158
Të tjera	3.233	1.808	23.069	18.426	16.483	13.147	102.082	97.186
<b>Gjithsej</b>	<b>39.461</b>	<b>37.877</b>	<b>292.523</b>	<b>272.163</b>	<b>81.666</b>	<b>70.558</b>	<b>527.701</b>	<b>509.272</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Korrik 2023**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Korrik 2022	Korrik 2023	Janar - Korrik 2022	Janar - Korrik 2023	Korrik 2022	Korrik 2023	Janar - Korrik 2022	Janar - Korrik 2023
<b>Gjithsej</b>	<b>39.461</b>	<b>37.877</b>	<b>292.523</b>	<b>272.163</b>	<b>81.666</b>	<b>70.558</b>	<b>527.701</b>	<b>509.272</b>
Ushqime, pije, duhan	4.000	4.787	29.347	35.394	14.001	13.206	85.546	82.471
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	6.979	9.689	63.597	60.618	13.488	7.929	82.887	57.576
Produkte kimike dhe plastike	1.466	1.277	11.742	9.106	10.902	8.628	67.890	68.517
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	203	185	1.733	1.751	1.521	1.185	10.545	8.888
Prodhime druri dhe letre	1.309	879	8.103	6.848	3.310	2.330	20.491	17.661
Tekstile dhe këpucë	12.162	11.440	80.568	79.543	8.688	7.897	58.821	56.312
Materiale ndërtimi dhe metale	8.751	5.303	67.796	47.249	10.866	8.127	79.087	72.338
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	3.379	3.278	22.404	24.204	15.967	18.237	102.978	124.692
Të tjera	1.214	1.038	7.231	7.450	2.924	3.018	19.456	20.817

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Korrik 2023**

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
<b>Gjithsej</b>	<b>134.015</b>	<b>119.763</b>	<b>22.085</b>	<b>23.779</b>	<b>16.054</b>	<b>18.558</b>	<b>20.235</b>	<b>14.810</b>
Ushqim, pije duhan	6.482	9.347	3.291	4.034	2.256	2.796	901	1.121
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	16.857	5.896	3.328	4.653	2.051	6.489	11.566	5.532
Produkte kimike dhe plastike	2.824	3.576	2.520	2.385	2.792	676	35	31
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.597	1.661	9	7	24	15	9	3
Prodhime druri dhe letre	4.953	4.091	791	667	1.229	1.089	216	75
Tekstile dhe këpucë	63.037	62.269	107	141	3.436	4.162	5.009	5.987
Materiale ndërtimi dhe metale	22.710	16.249	10.043	9.470	3.673	2.612	775	852
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	11.963	13.249	1.119	1.401	94	77	1.463	1.003
Të tjera	3.591	3.425	876	1.021	498	642	261	206

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Korrik 2023

	Itali		Kinë		Turqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
<b>Gjithsej</b>	<b>122.916</b>	<b>117.592</b>	<b>40.593</b>	<b>54.596</b>	<b>62.168</b>	<b>50.878</b>	<b>32.597</b>	<b>35.472</b>
Ushqim, pije duhan	16.392	16.139	847	1.118	3.761	3.541	3.363	3.425
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2.874	3.948	4	28	4.081	7.188	550	540
Produkte kimike dhe plastike	15.324	14.519	4.274	4.617	6.999	6.993	7.598	6.847
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	8.424	7.266	521	470	294	192	31	55
Prodhime druri dhe letre	4.536	4.097	649	1.094	3.243	2.882	710	547
Tekstile dhe këpucë	30.159	26.840	6.329	7.019	10.555	8.478	1.321	1.595
Materiale ndërtimi dhe metale	16.069	15.838	4.667	7.525	23.133	11.938	1.039	1.100
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	24.472	23.894	19.283	28.713	7.129	7.338	16.829	20.058
Të tjera	4.665	5.052	4.018	4.010	2.974	2.329	1.156	1.306



# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat,

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri